

POP

**PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE**



ZGJEDHJET VENDORE 14 MAJ 2023

KONTRATA SOCIALE



PUKË



Center for Strategic Studies and Policy
Qendra e Studimeve Strategjike dhe Politike



KONTRATA SOCIALE 2023 – 2027 BASHKIA PUKË

Përballja e Ofertave Politike (POP) është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare, të cilat punojnë në 12 bashki të Shqipërisë. Në bashkinë Pukë, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga Lëvizja Rinore për Demokraci (LRD). LRD është një organizatë joqeveritare, jopolitike, jofetare dhe jofitimprurëse që nxit aktivizimin qytetar, rritjen e demokracisë lokale dhe kontribuon në përmirësimin e jetës shoqërore e publike të komunitetit në Bashkinë Pukë dhe Fushë Arrëz nëpërmjet programeve të edukimit, ndërgjegjësimit, rritjes së kapaciteteve dhe avokimit. LRD në punën e saj shfaq dhe përkrah vlerat e Vullnetarizmit, Transparencës, Bashkëpunimit, të qenit Miqësorë me mjedisin, të qenit Jo-diskriminues.

Kontrata sociale hartohet nga POP në çdo fushatë elektorale gjatë Zgjedhjeve Vendore në Shqipëri. Kontrata sociale prezantohet te të gjithë kandidatët për kryetar bashkie gjatë periudhës së fushatës elektorale.

Në hartimin e kontratës sociale 2023-2027 janë marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e grupeve të ndryshme të qytetarëve brenda territorit të Bashkisë së Pukës, me një fokus të veçantë për grupet e cënueshme.

PRIORITETE KRYESORE

Prioriteti 1. Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor

- Krijimi i një strategjie të re në shpërndarjen e informacionit, kryesisht për ato që lidhen ngushtësisht me interesat e qytetarëve, ndikimin e jetës së tyre (si: programet e ndryshme të nxitjes së punësimit, biznesit, strehimit etj).
- Vendosja e disa këndeve informuese (info points) të digjitalizuara në pika strategjike të qytetit, me qëllim informimin e qytetarëve, kryesisht vizitorëve vendas dhe të huaj.
- Fuqizimi i mekanizmave komunitarë të përfaqësimit:
 - Këshilli Vendor i Rinisë dhe ndikimi i tij në politikat vendore për të rinjtë. Fuqizimi i Këshillave vendorë lokalë si mekanizma konsultues dhe monitorues të politikave rinore.
 - Këshilli Vendor i Sigurisë Publike.
- Nevojitet një përmirësim i informimit dhe komunikimit të Bashkisë me qytetarët në lidhje me programet e nxitjes së bizneseve dhe punësimit, për të cilat një pjesë e qytetarëve nuk kanë dijeni.

- Banorët kërkojnë të informohen më shumë mbi zhvillimin e takimeve, dëgjesave, konsultimeve publike dhe të Buxhetimit me Pjesëmarrje, në mënyrë që të jenë më të përfshirë në vendimmarrje për çështjet që i shqetësojnë.
- Bashkia duhet të ketë një plan kalendarik me takime periodike të përcaktuara për të gjitha njësitë administrative duke ndikuar në rritjen e ndërveprimit banorë – pushtet vendor
- Të përdoren kanale të ndryshme të komunikimit dhe jo vetëm përdorimin e mediave dhe platformave digjitale pasi një pjesë e konsiderushme e banorëve nuk ka mundësi të marrin informacionin përmes kësaj forme komunikimi.

Prioriteti 2. Nxjtja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor

- Prioritizimi i zhvillimit të programeve dhe shërbimeve për të rinjtë, duke amortizuar kështu trendin e largimit të të rinjve nga zona dhe vendi në kërkim të mundësive më të mira.
- Prioritizimi i investimeve në bujqësi, me fokus krijimin e mundësive të tregut për mallrat e prodhuara në vend nga të katër njësitë administrative dhe qyteti i Pukës.
- Krijimi i një fondi të veçantë në buxhet për të mbështetur nismat e sipërmarrjes rurale të drejtuara nga të rinjtë dhe gratë. Ky fond do të ofronte mbështetje financiare për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe startup në zonat rurale, me fokus fuqizimin dhe promovimin e pavarësisë ekonomike të të rinjve dhe grave.

PRIORITETE TË TJERA

Prioriteti 3. Drejtësia Sociale

- Të përshtatet një hapësirë ose banesë për shërbimin e strehimit 24 orësh të rasteve të dhunës në familje,
- Të mundësohet një ambient që të shërbejë si qendër sociale, qendër për gratë, për një socializim më të mirë dhe kujdes për banorët kryesisht mosha e tretë e njësisë administrative Gjegjan.
- Organizimi i më shumë fushatave dhe programeve ndërgjegjësuere kundër dhunës ndaj grave e vajzave dhe dhunës në familje.
- Të lobohet nga pushteti vendor sa i përket kontrollit periodik mjekësor Check-Up. Ky shërbim që ofrohet nga Drejtoria e Shëndetit Publik nuk duhet të ketë përcaktim në limit moshe 35 – 70 vjeç, por të jetë 35 vjeç e sipër – pa përcaktim moshe. Bashkia duhet të llojë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për përmbushjen e kësaj kërkesë të qytetarëve.

Prioriteti 4. Transport publik i aksesueshëm dhe i sigurtë për të gjithë qytetarët e Pukës.

- Afishimi i orareve të transportit ndërurban në stacionin e autobusëve dhe në të gjitha qendrat e 4 njësisë administrative të Pukës.
- Adresimi i problemit të mungesës së transportit lokal nga njësitë administrative në Pukë dhe anasjelltas, duhet marrë në konsideratë sa do i ndihmonte zonat rurale për çdo nevojë lëvizjeje, për punë, për nxënës e studentë, për probleme të kujdesit shëndetësor, për nxjerrjen e produkteve lokale bujqësore e blegtorale në treg etj.

Prioriteti 5. Shkollat, kopshtet dhe çerdhet

- Furnizim me ujë i shkollës 9-vjeçare në Qerret – Njësia administrative Luf-Qerret-Pukë
- Të përmirësohen kushtet sanitare në shkollën 9 – vjeçare “Migjeni”, shkollën e mesme “Sabah Sinani” Pukë duke i pajisur me ujë të ngrohtë, detergjentë e materiale higjienike
- Të plotësohen me bazë materiale laboratorët në shkollat e mesme dhe 9-vjeçare Pukë

Prioriteti 6. Infrastruktura rrugore

- Ndriçimi dhe sistemimi i rrugës së Tuneleve (nga Diga e liqenit deri te rruga Lagje e Re) - qyteti Pukë
- Shtrimi dhe sistemimi i rrugëve në lagjen sipër muzeut- qyteti Pukë
- Mirëmbajtja e rrugës së Kimzës në Njësinë Administrative Gjegjan, pasi makineritë e minierës kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme pa mirëmbajtjen e duhur.
- Vazhdimi i shtrimit të rrugës në të gjitha lagjet e fshatit Qerret.
- Investim i rrugës së Kabashit – njësia Administrative Rrape
- Ndërtimi i një ure të sigurtë për fshatin Kuzhnen – Njësia administrative Gjegjan
- Rikonstruksion total i rrjetit elektrik - fshati Qerret
- Ndërimi dhe shtimi i koshave të mbetjeve dhe shpeshtimi i pastrimit të tyre në Gjegjan, Qerret, si dhe në zonat periferike të qytetit Pukë

Prioriteti 7. Uji i Pijshëm dhe Kanalizimet

A. Uji i Pijshëm

- Furnizimi me ujë i shkollës në Qerret dhe i banesave në lagjen nr.2 pasi investimi i bërë është lënë në mes, të merren masa për klorinimin dhe kontrollin e cilësisë së ujit.
- Mungon uji i pijshëm për banorët e fshatit Kuzhnen - Gjegjan, kërkohet investim i rrjetit të ujsjellësit

B. Kanalizimet

- Ndërtimi i linjës së Kanalizimit të ujrave të zeza (KUZ) në lagjen nga Elektriку – Shtëpia Sociale Pukë duke shmangur ndotjen nga derdhja e tyre në përrua.
- Ndërtimi i KUZ në lagjen ish SMT – ja.

Prioriteti 8. Mbështetja e fermerëve

- Investime në bujqësi, me prioritet mundësia e tregut për produktet lokale të 4 njësive administrative dhe Pukës
- Përcaktimi në buxhet i një fondi të veçantë për mbështetje të nismave rurale të sipërmarrjes.
- Rikonstruksion i ish-qendrës së grumbullimit të frutave të pyllit, kërpudhës dhe bimëve medicinale në njësinë administrative Gjegjan.
- Kanal vaditës në fshatin Kushnen, që mbulon një sipërfaqe prej 10 ha; të ndërtohen me tubacione që të mos ketë nevojë për ndërhyrje vit pas viti.
- Investimi i kanalit vaditës Qerret
- Ndërtimi i kanalit vaditës Gugaj – Qelëz

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP” synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan